



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

KPPP.nr. 2425/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përmbartimore të kreditorit NGP “A-1” – M.M. B.I Sh.p.k, me numër unik identifikimi 811452614 me seli në Prishtinë, rr. “Prroni i Njelmtë” kundër debitorit Newco Ferronikeli Complex L.L.C. me numër unik identifikimi 810507444, me seli në Glllogoc, i cili sipas autorizimit përfaqësohet nga Shoqëria e avokatëve “SCRL Partners” Sh.p.k me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.221/2021 të datës 01.12.2021, lëshuar nga Përmbartuesi Privat Myjesere Mujku me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 31.07.2023, merr këtë:

### A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit Newco Ferronikeli L.L.C., i ushtruar ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr.221/2021 të datës 01.12.2021, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Myjesere Mujku.
- II. Urdhri përmbartimor P.nr.221/2021 i datës 01.12.2021, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Myjesere Mujku MBETET NË FUQI.

### A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit NGP “A-1” – M.M. B.I Sh.p.k, ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr.221/2021 të datës 01.12.2021, me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumenteve: faturë nr. 06/0121 e datës 25.01.2021, faturë nr. 08/0321 e datës 17.03.2021, faturë nr. 12/0321 e datës 29.03.2021, faturë nr. 02/0421 e datës 19.04.2021, faturë nr. 07/0721 e datës 27.07.2021, faturë nr. 10/0721 e datës 30.07.2021, faturë nr. 01/0821 e datës 09.08.2021, faturë nr. 04/0821 e datës 30.08.2021, faturë nr. 05/0821 e datës 30.08.2021, faturë

nr. 01/1021 e datës 01.10/2021, faturë nr. 02/1021 e datës 01.10.2021 duke detyruar debitorin që t'ia paguaj kreditorit shumën e përgjithshme prej 1,952.46€ (njëmijë e nëntëqind e pesëdhjetë e dy euro dhe katërdhjetë gjashtë cent), me kamatëvonesë për vonesë si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Debitori, brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim ndaj Urdhrit Përmbartimor duke theksuar se faturat nuk kanë tipare të përmbartueshmërisë dhe të njëjtat nuk e përmbajnë afatin e pagesës së faturave andaj, Gjykatës i ka propozuar që të aprovohet prapësimi i debitorit si i bazuar dhe të anulohet Urdhri Përmbartimor.

Kreditori ka parashtruar përgjigje në prapësim duke theksuar se për çdo faturë të lëshuar për debitorin ka pasur urdhër blerje dhe kërkesë për ofertë nga debitori dhe çdo ofertë e lëshuar e ka të cekur afatin e pagesës prej 30 ditësh. Tutje shton se kreditori ka kërkuar nga debitori përmes email-it, telefon dhe verbalisht përmbushjen e obligimeve në bazë të faturave. Me kërkesë që të refuzohet prapësimi i debitorit dhe të mbetet në fuqi urdhri përmbartimor P.nr.221/2021.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me nën-par.1.3 të këtij neni fatura përcaktohet si një nga dokumentet e besueshme, kurse me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, dhe me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*.

Gjykata në rastin konkret vlerëson se faturat e lartcekura në bazë të së cilave është lejuar urdhri për përmbartim, i plotësojnë kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara në përputhje me nenin 29 dhe 37 të LPP-së, kjo pasi që në fatura janë treguar

palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara qartë shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturave, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit dhe faturat janë pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt përmes nënshkrimit të tyre.

Gjykata pati parasysh pretendimet e debitorit se fatura nuk përmban afatin e përmbushjes vullnetar të detyrimit, por në vlerësimin e Gjykatës, në rastet kur fatura nuk përmban afatin e përmbushjes, nënkuptohet se e njëjta është bërë e arritshme dhe duhet përmbushur në datën e lëshimit të saj, e më së voni në kohën kur përmbushja e këtij detyrimi kërkohet në procedurë gjyqësore, kjo në ndërlidhje edhe me nenin 305, par.1 të LMD-së i cili përcakton se " *Në qoftë se afati për përmbushje nuk është caktuar, debitori është në vonesë kur kreditori ta ftojë që ta plotësojë detyrimin e vet, verbalisht ose me shkrim, paralajmërim jashtë gjyqësor, ose duke filluar ndonjë procedurë, qëllimi i së cilës është realizimi i përmbushjes të detyrimit*".

Nga të lartcekurat, e në kuptim të nenit 71 par. 1.1 dhe 73 të LPP-së, si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

#### GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 2425/22, datë 31.07.2023

Gjyqtari

Florent Zeqiri

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.